

**VENDIM**  
**Nr. 1186, datë 24.12.2020**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË OBJEKTEVE ME RËNDËSI EKONOMIKE E STRATEGJIKE, PRANË TË CILAVE NGRIHEN STACIONET E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike në shkallë vendi, pranë të cilave ngrihen stacionet e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 288, datë 27.6.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimit në objektet me rëndësi ekonomike dhe shtetërore”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministritë përgjegjëse dhe subjektet përkatëse, që kanë në pronësi apo përgjegjësi administrimi objektet e përcaktuara në këtë vendim, për marrjen e masave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**LISTA E OBJEKTEVE ME RËNDËSI EKONOMIKE E STRATEGJIKE NË SHKALLË VENDI, PRANË TË CILAVE NGRIHEN STACIONET E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

1. Aeroportet;
2. Portet detare;
3. Tunelet mbi 1 km, përveç kur me kontratë të veçantë përcaktohet ndryshe;
4. Hidrocentralet në pronësi të shoqërisë KESH sh.a.;
5. Portile ku parkohen mjete lundruese;
6. Pikat hyrëse dhe dalëse të linjës magjistrale të transmetimit të gazit natyror dhe naftës bruto;
7. Depozitat e përdorura nga kompanitë e prodhimit dhe të përpunimit të naftës bruto dhe gazit;
8. Depozita të ruajtjes dhe të shpërndarjes së naftës bruto e nënprodukteve të saj me shumicë mbi 3000 m<sup>3</sup>, të gazit të lëngshëm me mbi 500 m<sup>3</sup>;
9. Zonat e mbrojtura natyrore, sipas legjislacionit në fuqi.